



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.63

14 maj

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 121
datë 11.5.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër të huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe vendore”

2857

Ligj nr.10 122
datë 11.5.2009

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për një financim shtesë për projektin e ofrimit të shërbimeve sociale”

2882

LIGJ
Nr. 10 121, datë 11.5.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES KUADËR TË HUASË NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË
EUROPËS (CEDB) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE
VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja kuadër e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës (CEDB) për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe vendore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekreten nr.6162, datë 13.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

F/P 1665 (2009) W

MARRËVESHJE KUADËR HUAJE

**NDËRMJET BANKËS SË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR ZHVILLIM DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Banka e Këshillit të Europës për Zhvillim, Organizatë Ndërkombëtare, Paris (këtu quhet CEB), nga njëra anë,

Dhe

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Bv. Dëshmorët e Kombit, Tirana, Republika e Shqipërisë (këtu të quajtur Huamarrësi),

- *Duke pasur parasysh* kërkesën e paraqitur nga Qeveria Anëtare e Shqipërisë, të datës 19 janar 2009;

- *Duke pasur parasysh* Protokollin e Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës;

- *Duke pasur parasysh* Rezolutën e Këshillit Administrativ të CEB-it: 1495 (2006),

- *Duke pasur parasysh* Rregulloret e Huave të CEB-it të datës qershor 2006 (këtu, Rregullore të Huasë).

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Përkufizime

“Alokimi i një Transhi” (këtu quhet edhe “Alokim” ose “I alokuar”) është caktimi i një

Transhi nga huamarrësi tek pjesët përbërëse të Projektit (të identifikuar nëpërmjet një tablele standardesh që i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje Kuadër huaje) edhe nëse ky Transh nuk është paguar nga Projekti.

“Datë e Parashikuar për Përfundimin e Projektit” është data e parashikuar për përfundimin fizik të Projektit, sipas përcaktimit nga Huamarrësi në kohën e aprovimit të Projektit të Këshilli Administrativ i CEB-it ose Komiteti i tij Ekzekutiv, siç tregohet në Nenin 3.3.

“Ditë Pune” është një ditë në të cilën Sistemi TARGET (Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer System) është në punë.

“Data e Mbylljes” është data që bie gjashtë muaj pas Datës së Parashikuar për Përfundimin e Projektit, siç tregohet në Nenin 3.3.

“EURIBOR” (Euro Interbank Offered Rate) është norma sipas së cilës depozitat me afat ndër-bankare në Euro brenda zonës së Euros ofrohen nga një bankë primare tek një bankë tjetër primare. Kjo sponsorizohet nga Federata Bankare Evropiane, e llogaritur nga Reuters dhe publikohet çdo ditë pune në Bruksel, në orën 11 00 në faqen e Reuters-it EURIBOR01.

“Përfitues Fundor” është personi fizik ose juridik ose grupi social që përfiton nga efektet sociale të Projektit.

“Konventa e Modifikuar e Ditës Pasuese të Punës” është një konventë sipas së cilës nëse një ditë e caktuar do të binte në një ditë që nuk është Ditë Pune, kjo datë do të ishte dita e parë pasuese që është Ditë Pune, përveç kur kjo ditë bie në muajin pasues kalendarik dhe në këtë rast kjo datë do të ishte dita e mëparshme më e afërt me të që është Ditë Pune.

“Agjencia për zbatimin e Projektit” (këtu quhet PIA) është Fondi Shqiptar për Zhvillimin, që nëpërmjet delegimit nga Huamarrësi, zbaton dhe menaxhon Projektin.

“Gjendja e Parashikuar e Përparimit të Punëve” është raporti i shpenzimeve të përshtatshme për të gjitha pjesët përbërëse të Projektit me koston e përshtatshme të plotë të Projektit, ku shpenzimet e përshtatshme përfshijnë shpenzimet e shkaktuara dhe ato që priten të bëhen për një periudhë të caktuar kohe që nuk kalon një vit nga data e raportit të monitorimit (siç parashikohet në Nenin 4.2.2. më poshtë).

“Llogaria e Zgjedhur e Besimit” është llogaria që ekziston tek CEB-i me qëllimin e dhënies së subvencioneve të normës së interesit për huatë e dhëna nga Banka dhe për të dhënë dhurime në vendet e përshtatshme.

“Gjendja e Përparimit të Punëve” është raporti i shpenzimeve të kryera për të gjitha pjesët përbërëse të Projektit me koston e përshtatshme të Projektit.

“Transh” është shuma e disbursuar ose që do të disbursohet nga Huaja.

Neni 1

Kushte të Përgjithshme

Kjo hua jepet në bazë të kushteve të përgjithshme të Rregulloreve të Huasë dhe në bazë të kushteve të veçanta të përcaktuara nga kjo marrëveshje kuadër huaje (këtu quhet Marrëveshje), Shtojcat e saj dhe letrat shoqëruese (këtu quhen Letra Shoqëruese).

Neni 2

Projekti

CEB-i i jep Huamarrësit, i cili pranon një hua (këtu Huaja) për financimin e pjesshëm të F/P 1665 (2009) të aprovuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it më 13 mars 2009, dhe në lidhje me financimin e pjesshëm të ri-ndërtimit/rehabilitimit të rrugëve dytësore dhe lokale që gjenden në të gjithë vendin.

Huaja jepet nga CEB-i duke pasur parasysh përkushtimin që Huamarrësi po tregon për të zbatuar atë vetëm për të financuar projektin e përshkruar në Shtojcën 1 (këtu quhet Projekti), dhe për të kryer këtë Projekt në kushtet që janë detajuar në këtë Shtojcë.

Çdo ndryshim për mënyrën se si zbatohet huaja që nuk merr pëlqimin e CEB-it mund të çojë në pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të Huasë, sipas kushteve të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 3

Huaja

3.1 Kushtet financiare

Shuma e Huasë që jepet është:

40 000 000 Euro
Dyzet milion Euro

Ajo disbursohet me Transhe.

Për çdo Transh, shuma, norma e interesit, data e disbursimit dhe periudha e shlyerjes (afatet mund të jenë deri në 20 vjet duke përfshirë periudhën pa pagesë deri në 5 vjet) dhe llogaritë e dërgesave të secilës pale, përcaktohen së bashku nga Huamarrësi dhe CEB-i.

Një Letër Shoqëruese që përcakton këto kushte do të hartohet në momentin e disbursimit thelbësisht në formën e caktuar në shtojcën 2a dhe 2b.

3.2 Kontributi nga Llogaria e Zgjedhur e Besimit

Norma e interesit për çdo kësht të huasë do të subvencionohet nga Llogaria e Zgjedhur e Besimit të CEB-it. Ky subvencion nuk mund të kalojë 2 000 000 Euro për shumën e plotë të projektit të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it. Subvencioni do të zbatohet proporcionalisht në çdo kësht të huasë. Megjithatë, në rast se norma e interesit para subvencionimit do të ishte poshtë normës së subvencionit, subvencioni do të jetë e barabartë me atë normë.

3.3 Kontributi nga Llogaria Norvegjeze e Besimit

Një komponent i asistencës teknike bazuar në grantin prej 180 000 euro do të vijë nga Llogaria Norvegjeze e Besimit të CEB-it (shih detajet në Shtojcën 1 më poshtë).

3.4. Disbursimi

CEB-i disburson Huanë në minimalisht dy Transhe. Shuma e secilit Transh do të përcaktohet sipas Gjendjes së Përparimit të Punëve.

Disbursimi i parë duhet të kryhet brenda 12 muajve pas ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje siç përcaktohet në Nenin 15, duke përmblusur parakushtet që shprehen në shtojcën 1.

Transhi i parë nuk kalon 50% të shumës së huasë së aprovuar.

Çdo transh pasues mund të disbursohet vetëm pasi Huamarrësi t'i konfirmojë me shkrim CEB-it, në përmblusje të Nenit 4.2.2 më poshtë, që është alokuar 90% e Transhit të mëparshëm. Transhet pasuese llogariten mbi bazën e Gjendjes së Përparimit të Punës dhe – sipas rastit – të Gjendjes së Parashikuar të Përparimit të Punëve.

3.5. Data e Parashikuar për Përfundimin e Projektit dhe Data e Mbylljes

Data e Parashikuar për Përfundimin e Projektit është 30 qershori 2012.

Data e Mbylljes është 31 dhjetori 2012. Nga kjo datë dhe pas njoftimit të CEB-it drejtuar huamarrësit, nuk mund të bëhet asnjë tërheqje nga Huamarrësi.

3.6. Hollësi për pagesat

Të gjitha shumat që duhet të paguhet nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje paguhet në monedhën e secilit Transh në numrin e llogarisë të komunikuar nga CEB-i Huamarrësit në momentin e disbursimit.

Huamarrësi ose banka e udhëzuar nga Huamarrësi, sipas rastit, i dërgon një njoftim me shkrim për pagesën CEB-it të paktën pesë ditë pune para pagesës së çdo shume që duhet të paguhet sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo pagesë sipas kësaj Marrëveshjeje bëhen në një Ditë Pune sipas Konventës së Modifikuar të Ditës Pasuese të Punës.

Neni 4

Monitorimi i Huasë dhe Projektit

4.1. Përdorimi i Huasë

4.1.1. Periudha

Transhet duhet të alokohen nga Huamarrësi në Projekt brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve pas çdo disbursimi.

Shuma që nuk alokohet në Projekt brenda një afati të tillë duhet t'i kthehet CEB-it, jo më vonë se brenda 30 ditëve.

Huamarrësi merr përsipër të përballojë shpenzimet që rrjedhin nga kjo shlyerje. Këto shpenzime do të përfshijnë ato që duhet të përballojë CEB-i për shkak të ri-investimit së të njëjtës shume në datën e shlyerjes për periudhën e mbetur të huasë origjinale, si dhe çdo kosto tjetër të lidhur me të. Norma e ri-investimit përcaktohet nga CEB-i në bazë të kushteve të tregut në datën e shlyerjes dhe për periudhën në fjalë. Kështu kostoja llogaritet duke marrë parasysh diferencën ndërmjet normës origjinale dhe asaj të ri-investimit.

Për më tepër, nëse një Transh i disbursuar nga CEB-i nuk alokohet në Projekt ose alokohet vetëm pjesërisht në të brenda periudhës së përmendur në paragrafin e parë më sipër, kjo do të përbënte një ngjarje të renditur në Nenin 3.3(h) të Kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë dhe mund të bëhet shkak për pezullimin, anulimin ose shlyerjen e parakohshme të Huasë sipas termave të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

4.1.2. Zbatimi i Projektit

Huamarrësi cakton Fondin Shqiptar për Zhvillimin (ADF) si PIA. PIA do të realizojë zbatimin, bashkërendimin mbikëqyrjen e Projektit dhe raportimin tek CEB-i. Projektin do të zbatohet sipas procedurave menaxhuese, financiare dhe prokuruese të BB-së. Huamarrësi do të sigurojë që PIA ka personelin dhe pajisjet e duhura për zbatimin e Projektit. CEB-i do të njoftohet në lidhje me çdo ndryshim brenda strukturës organizative dhe personelit kryesor të PIA-s. Megjithatë, përgjegjësia për të përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje i mbetet Huamarrësit.

Të gjitha shumat nga huaja e CEB-it do të kalojnë nëpërmjet një Llogarie të Veçantë të hapur nga Huamarrësi tek Banka Qendrore e Shqipërisë. Huamarrësi e transferon Huanë e CEB-it në Llogarinë e Projektit të hapur në një bankë tregtare dhe që është vetëm për këtë Projekt. Personeli i PIA-s do të autorizohet të operojë Llogarinë e Veçantë dhe do të jetë përgjegjës për administrimin e transheve të huasë së CEB-it. Të gjitha transaksionet do të autorizohen, regjistrohen dhe raportohen nga PIA.

4.1.2.1. Detyra e kujdesit

Huamarrësi tregon të gjithë kujdesin dhe vëmendjen dhe ushtron zakonisht të gjitha mjetet e zbatueshme, veçanërisht mjetet financiare, teknike, sociale dhe menaxhuese dhe ato në lidhje me mbrojtjen e ambientit, që do të jenë të nevojshme për zbatimin e duhur të Projektit.

4.1.2.2. Kostoja e rritur ose e rishikuar e Projektit

Nëse kostoja e Projektit, sipas përshkrimit në Shtojcën 1 të bashkangjitur, rritet ose rishikohet për një arsye të caktuar, Huamarrësi siguron që burimet shtesë financiare për përfundimin e Projektit të jenë në dispozicion.

Ai siguron veçanërisht – para se Projektin të zbatohet – që i gjitha të drejtat e financimit, të tokës dhe të pasurive të paluajtshme që janë të nevojshme të jenë në dispozicion dhe të gjitha sendet pasurore dhe impiantet të jenë të siguruar dhe mirëmbajtura përgjithmonë.

Në çdo rast, financimi i pjesshëm nga CEB-i nuk është më shumë se 53.2% e koston së përgjithshme të Projektit, duke përjashtuar interesin dhe detyrimet financiare, siç përcaktohen në Shtojcën 1.

4.1.2.3. Tregueshmëria e CEB-it

Huamarrësi u vë në dukje përfituesve që Projektin financohet pjesërisht nga CEB-i. Informacioni i dhënë shtypit, si dhe dokumentet publike që i përkasin projektit njohin faktin që Projektin është bashkë-financuar “me fonde nga Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillimin”. Po kështu, në terren do të vendose pllakata reklame gjatë punimeve dhe ADF-ja do të shpallë logon e CEB-it kurdoherë që shpallet një njoftim publik në lidhje me investimet e financuara nga shumat e CEB-it.

4.1.2.4. Sipërmarrje të tjera

Huamarrësi, për më tepër, merr përsipër që:

Zbatimi i Projektit përputhet me të gjitha rregullat përkatëse mbi mashtrimin, korrupsionin dhe pastrimin e parave;

Zbatimi i Projektit nuk çon në ndonjë shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane;

Projektin përputhet me Parimet e Menaxhimit të Ambientit të CEB-it (Shtojca 3).

4.1.3. Prokurimi

Projektin do të zbatohet në mënyrë të njësuar sipas procedurave menaxhuese, financiare dhe

prokuruese të BB-së. CEB-i do të lejojë që: të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet (të ndryshme nga shërbimet e konsulentëve) që kërkohen për projektin të prokurohen në pajtim me kërkesat e parashikuara ose përmendura në Udhëzimet e Bankës Botërore për Prokurimin sipas Huave të IBRD-së dhe Kredive të IDA-s, të publikuara nga Banka në maj 2004 dhe rishikuar në tetor 2006 (këtu quhen Udhëzimet e Bankës Botërore) të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për Projektin do të prokurohen në pajtim me kërkesat e parashikuara ose përmendura në Udhëzimet e Bankës Botërore për Zgjedhjen dhe Punësimin e Konsulentëve, të publikuara nga Banka në maj 2004 dhe rishikuar në tetor 2006.

Nëse zbatohen procedurat Kombëtare me Ofertë Konkurruese për prokurimin e punëve dhe mallrave në bazë të Udhëzimeve të Bankës Botërore, këto duhet të kontraktohen sipas parimeve dhe rregullave specifike të detajuara në Marrëveshjen e Financimit të nënshkruar nga Shqipëria me Shoqatën Ndërkombëtare për Zhvillimin më 2 korrik 2008, që është Programi 2 – Ekzekutimi i Projektit, Seksioni III, - Metoda të Veçanta për Prokurimin e Mallrave, Punëve dhe Shërbimeve (Të ndryshme nga Shërbimet e Konsulentëve).

Para kështit të parë të huasë, PIA i paraqet CEB-it një Plan Prokurimi të përpiluar në pajtim me Udhëzimet e Bankës Botërore. CEB-i nuk financon shpenzimet për mallrat, shërbimet dhe punët që nuk janë parashikuar në Marrëveshjen e Huasë dhe që regjistrohen më tej në Planin e Prokurimit. Në këto raste, CEB-i do të deklarojë keq-prokurimin dhe është politika e CEB-it të anulohet atë pjesë të huasë së alokuar për mallrat dhe punët për të cilat është deklaruar keq-prokurimi. Kjo do të përbënte një ngjarje sipas renditjes në Nenin 13-h të Kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e parakohshme të Huasë sipas termave të Nenit 13 të Rregulloreve të Huasë.

Huamarrësi njofton menjëherë CEB-in për çdo vonesë ose ndryshim tjetër në grafikun e procesit të prokurimit, që do të ndikonte në masë të konsiderueshme në zbatimin në kohë dhe të suksesshëm të kontratave të projektit dhe merret vesh me CEB-n për masat korrigjuese.

CEB-i nuk do të deklarojë mungesën e kundërshtimit për masat e prokurimit të propozuar nga Huamarrësi, duke përfshirë paketën e kontratës, procedurat e zbatuara, por rezervon të drejtën të kryejë rishikimin paraprak ose pasues të dokumentacionit të prokurimit me bazë modeli.

Në çdo rast përgjegjësia për zbatimin e projektit dhe përgjegjësia për dhënien dhe administrimin e kontratave sipas projektit i takon Huamarrësit.

4.2. Kërkesat për informacion

4.2.1. Informacioni në lidhje me Projektin

Huamarrësi, nëpërmjet PIA-s, mban regjistra llogarish për Projektin që janë në pajtim me standardet ndërkombëtare që tregojnë, në çdo moment, gjendjen e progresit të Projektit, dhe që shënon të gjitha operacionet e bëra, dhe identifikon sendet pasurore dhe shërbimet e financuara me ndihmën e Huasë.

Huamarrësi nëpërmjet PIA-s merr përsipër të reagojë brenda një periudhe të arsyeshme ndaj çdo kërkesë për informacion nga CEB-i dhe t'i japë atij çdo dokument që CEB-i e konsideron të nevojshëm dhe mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për zbatimin e përshtatshëm të Marrëveshjes, veçanërisht në lidhje me monitorimin e Projektit dhe përdorimin e Huasë.

Huamarrësi informon CEB-in menjëherë për çdo ndryshim ligjor ose rregullator në sektorin ekonomik që prek Projektin dhe, në kuptimin e përgjithshëm, për çdo ngjarje që mund të ketë ndikim në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim ligjor ose rregullator në sektorin ekonomik që ja një efekt material negativ mbi Projektin do të përbënte një ngjarje të renditur në Nenin 3.3-h të Kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e parakohshme të Huasë sipas kushteve të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

4.2.2. Raportet e monitorimit

Të paktën një herë në vit, nga disbursimi i Huasë deri në përfundimin e të gjithë Projektit, Huamarrësi nëpërmjet PIA-s i dërgon CEB-it një raport monitorimi. Huamarrësi, nëpërmjet PIA-s, i dërgon gjithashtu një raport monitorimi para çdo disbursimi, me përjashtim të Transhit të parë. Këta raporte duhet të konsiderohen të pranueshëm nga CEB-i para se të bëhet ndonjë disbursim.

Shtojca 4 jep modelin që përcakton informacionin minimal që kërkohet nga CEB-i për raportet e monitorimit. Mund të përdoren formate alternative që përmbajnë të njëjtin informacion.

Në çdo rast, raportet e monitorimit duhet të përmbajnë:

- gjendjen e alokimit të Transheve të disbursuara të Huasë;

- përparimin e planeve të financimit dhe prokurimit të Projektit;
- përparimin e vetë projektit, në kuptimin e përparimit fizik dhe shpenzimeve të realizuara;
- Hollësi për menaxhimin e Projektit.

4.2.3. Raport i përfundimit të projektit

Me përfundimin fizik të të gjithë Projektit, Huamarrësi paraqet, nëpërmjet PIA-s një raport përfundimtar që përmban një vlerësim të efekteve ekonomike, financiare, sociale dhe ambientaliste të Projektit. Ky raport duhet të konsiderohet i pranueshëm nga CEB-i.

4.2.4. Misionet e monitorimit

Huamarrësi nëpërmjet PIA-s merr përsipër të pranojë pozitivisht çdo mision monitorimi që kryhet nga punonjësit e CEB-it ose konsulentë të jashtëm të punësuar nga CEB-i dhe të ofrojë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për misionet e tyre të monitorimit, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme në vendin e Projektit. Veçanërisht, CEB-i mund të zhvillojë një auditim në terren të llogarive të Projektit, që kryhet nga një ose më shumë konsulentë të zgjedhjes së tij me shpenzimet e Huamarrësit, në rastin e mosplotësimit në kohe nga Huamarrësi në lidhje me një prej detyrimeve të tij për këtë Hua.

4.2.5. Informacioni në lidhje me Huamarrësin

Huamarrësi siguron që PIA t'i dorëzojë CEB-it raportet e saj financiare vjetore dhe gjysmë-vjetore ose semestrale, nëse këto raporte publikohen.

Neni 5

Përmbushja e detyrimeve të Huamarrësit

Pasi të paguhet shuma e plotë e principalit të kësaj Huaje dhe të gjithë interesat dhe shpenzimet që rrjedhin prej tyre, veçanërisht shumat sipas Neneve 6 dhe 7 më poshtë, Huamarrësi të lirohet plotësisht nga detyrimet e tij kundrejt CEB-it, me përjashtim të atyre të parashikuara në Nenet 4.2.1 dhe 4.2.4 më sipër për qëllimet e një vlerësimi të mundshëm të mëvonshëm të Projektit.

Neni 6

Interesi për vonesat

Për disbursimet në Euro dhe pavarësisht mjeteve të tjera që ka CEB-i në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe Rregulloreve të Huasë, apo të tjera, nëse Huamarrësi nuk e paguan të gjithë interesin ose ndonjë shumë të pagueshme në bazë të Marrëveshjes brenda periudhës së parashikuar për pagesën, Huamarrësi duhet të paguajë interes shtesë për shumën e kërkueshme që nuk është paguar plotësisht, në normën një mujore EURIBOR në datën e kërkueshme në orën 11 para dite (ora lokale e Brukselit), plus 2.5% në vit, që nga data e kërkueshme e kësaj shume deri në datën e kësaj pagese.

Norma e zbatueshme një mujore EURIBOR përditësohet çdo 30 ditë.

Neni 7

Shpenzimet dytësore

Të gjitha pagesat dhe taksat e të gjitha llojeve, të kërkueshme dhe të paguara, dhe të gjitha shpenzimet që rrjedhin ose nga përfundimi, ekzekutimi, likuidimi i Marrëveshjes, plotësisht ose pjesërisht, ose ri-financimi i Huasë së dhënë, së bashku me të gjithë veprimet gjyqësore dhe jo-gjyqësore që kanë si origjinë këtë Hua, përballohen nga Huamarrësi.

Megjithatë, dispozitat e Nenit 7.4 të Kapitullit 4 të Rregulloreve të Huasë zbatohen në lidhje me shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të përmendur në Kapitullin 4.

Neni 8

Pari Passu dhe mosmarrja e zotimeve

Huamarrësi deklaron që asnjë detyrim tjetër nuk është marrë përsipër dhe nuk do të merret në të ardhmen që do t'i jepte një pale të tretë një radhë preferenciale, ose një radhë preferenciale pagese,

kolateral ose garanci e çdo natyre që do t'u jepnin palëve të treta të drejta të avancuara (këtu quhen Garanci).

Nëse një Garanci e tillë i jepet një pale të tretë, Huamarrësi bie dakord të formojë ose të japë një Garanci identike në favor të CEB-it ose, nëse nuk e bën dot këtë, një Garanci ekuivalente dhe të parashikojë formimin e një Garancie të tillë në favor të CEB-it.

Mospërbushja e këtyre dispozitave do të përfaqësonte një rast vonese sipas parashikimit të Nenit 3.3(h) të Kapitullit 3 të Rregulloreve të Huasë të CEB-it dhe mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të huasë sipas kushteve të Neneve 3.3, 3.5 dhe 3.6 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 9

Përfaqësimet dhe Garancitë

Huamarrësi përfaqëson dhe garanton:

- që organet e tij kompetente e kanë autorizuar atë të lidhë Marrëveshjen dhe i kanë dhënë nënshkruesit autorizimin për këtë, në pajtim me ligjet, dekretet, rregulloret, dispozitat e organizatave dhe teksteve të tjerë të zbatueshëm për të;

- që hartimi dhe përfundimi i Marrëveshjes nuk bie në kundërshtim me ligjet, dekretet, rregulloret, dispozitat e organizatave dhe teksteve të tjerë të zbatueshëm për të dhe të gjitha lejet, licencat dhe autorizimet e nevojshme për këtë janë marrë dhe mbeten të vlefshme për të gjithë periudhën e Huasë.

Çdo ndryshim në lidhje me përfaqësimet dhe garancitë e mëposhtme, për të gjithë periudhën e huasë, duhet t'i njoftohet menjëherë CEB-it dhe t'i jepet çdo dokument shoqërues.

Neni 10

Raporti me palët e treta

Huamarrësi nuk mund të ngrejë asnjë fakt në lidhje me marrëdhëniet e tij me palët e treta në kuadrin e përdorimit të Huasë me qëllim që të mënjanojë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje pjesërisht ose plotësisht.

CEB-i nuk mund të përfshihet në mosmarrëveshje që mund të lindin ndërmjet Huamarrësit dhe palëve të treta dhe shpenzimet e çdo natyre të shkaktuara nga CEB-i për shkak të një kundërshtimi dhe veçanërisht të gjitha shpenzimet ligjore dhe gjyqësore, përballohen nga Huamarrësi.

Neni 11

Interpretimi i Marrëveshjes

Huamarrësi deklaron që ai ka marrë një kopje të Rregulloreve të Huasë dhe i ka njohur ato.

Nëse ka një kontradiktë ndërmjet dispozitave të çfarëdoshme të Rregulloreve të Huasë dhe çdo dispozite të Marrëveshjes, mbizotërojnë dispozitat e Marrëveshjes.

Titujt e paragrafëve, seksioneve dhe kapitujve të Marrëveshjes nuk shërbejnë për interpretimin e tyre.

Në asnjë rast nuk prezumohet që CEB-i ka hequr dorë heshturazi nga ndonjë e drejtë në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Ligji i zbatueshëm

Marrëveshja, Shtojcat e saj dhe Marrëveshjet e Disbursimit në lidhje me të rregullohen nga rregullat e CEB-it sipas parashikimit të dispozitave të Nenit 1, paragrafi 3, të Protokollit të Tretë (të datës 6 mars 1959) të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës (e datës 2 shtator 1949) dhe, si dytësore, sipas rastit, ligji francez.

Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve në Marrëveshje i nënshtrohen arbitrazhit në kushtet e parashikuara në Kapitullin 4 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 13

Ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit

Palët kontraktuese bien dakord të mos përdorin asnjë privilegj, imunitet apo legjislacion para një autoriteti juridiksional ose tjetër, vendas ose i huaj, me qëllim që të kundërshtojnë ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të dhënë në kushtet e parashikuara në Kapitullin 4 të Rregulloreve të Huasë.

Neni 14

Njoftimet

Çdo njoftim ose komunikim tjetër që i jepet ose i bëhet në bazë të kësaj Marrëveshjeje CEB-it ose Huamarrësit bëhet me shkrim dhe mendohet të jetë dhenë ose bërë rregullisht nëse ai jepet dorazi, postë ajrore ose faks nga njëra palë drejtuar tjetrës në adresën e palës të përcaktuar më poshtë.

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr 1
Tirane, Republika e Shqipërisë
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Fax. ++355 42 228 494

Për CEB-in:

Council of Europe Development Bank
55 Avenue Kleber
75116 Paris
Në vëmendje të: Drejtor i Përgjithshëm për Huatë
Fax +33 1 47 55 37 52.
Të gjitha komunikimet jepen ose bëhen në gjuhën angleze.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga CEB-i dhe Huamarrësi dhe ratifikimin e saj nga Parlamenti Shqiptar.

Neni 16

Kopjet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hartohet në dy origjinale, secili prej të cilëve është njëlloj i vlefshëm.

Një kopje origjinale mbahet nga secila prej palëve kontraktuese.

Tiranë

Më _____
Për Republikën e Shqipërisë
Huamarrësi

Paris

Më _____
Për CEB-in
Guvernatori/Zëvendësguvernatori

LISTA E SHTOJCAVE

SHTOJCA 1	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
SHTOJCA 2a/b LETËR	SHOQËRUESE (MODEL)
SHTOJCA 3	PARIMET E MENAXHIMIT TË AMBIENTIT
SHTOJCA 4	RAPORTET E MONITORIMIT (MODEL)

Shtojca 1

Përshkrimi i Projektit

I.	F/P :	1665 (2009)																											
	Huamarrësi:	Republika e Shqipërisë																											
	Aprovuar nga Këshilli Administrativ:	Aprovuar me vendim të Këshillit Administrativ të xx mars, 2009																											
	Shuma e aprovuar:	40 000 000 Euro																											
II.	Sferat e ndërhyrjes:	Përmirësimi i kushteve të jetesës në zonat urbane dhe rurale																											
	Punët e planifikuara:	Ka tre Komponentë në Projekt: përmirësimi i seksioneve prioritare në rrjetin e rrugëve dytësore (rajonale) në Shqipëri; përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit të rrugëve lokale në Shqipëri; prezantimi i sektorit privat në mirëmbajtjen e rrugëve dytësore dhe lokale dhe forcimi i menaxhimit të rrjetit të rrugëve dytësore dhe lokale																											
	Vendndodhja:	Në të gjithë Shqipërinë																											
	Kosto e përgjithshme e vlerësuar për Projektin	Kosta totale e Projektit, siç vlerësohet gjatë periudhës së vlerësimit, është rreth 400 milionë USD (ekuivalenti i 312.5 milion Euro*). Plani Financiar i siguruar në momentin e aprovimit të CEB-it, së bashku me kontributin e CEB-it (vetëm hua), është si më poshtë: <table><tr><td>Financues</td><td>Shuma (EUR)*</td><td>Shuma (USD)</td><td>% pjesë</td></tr><tr><td>BB/IDA</td><td>15.6 milion</td><td>20 milion</td><td>20.7</td></tr><tr><td>Fondi i OPEC-ut</td><td>11.7 milion</td><td>15 milion</td><td>15.5</td></tr><tr><td>Fondet EU/IPA 2008</td><td>8 milion</td><td>10.2 milion</td><td>10.6</td></tr><tr><td>CEB</td><td>40 milion</td><td>51.2 milion</td><td>53.1</td></tr><tr><td>TOTAL i Siguruar</td><td>75.3 milion</td><td>96.4 milion</td><td></td></tr></table> *Norma e këmbimit e datës 21/01/2009 EUR/USD = 1.28 Huaja e CEB-it do të financojë përjashtimisht dy Komponentët e parë (punët civile pa TVSH) në listën e saj të veçantë të nën-projekteve.				Financues	Shuma (EUR)*	Shuma (USD)	% pjesë	BB/IDA	15.6 milion	20 milion	20.7	Fondi i OPEC-ut	11.7 milion	15 milion	15.5	Fondet EU/IPA 2008	8 milion	10.2 milion	10.6	CEB	40 milion	51.2 milion	53.1	TOTAL i Siguruar	75.3 milion	96.4 milion	
Financues	Shuma (EUR)*	Shuma (USD)	% pjesë																										
BB/IDA	15.6 milion	20 milion	20.7																										
Fondi i OPEC-ut	11.7 milion	15 milion	15.5																										
Fondet EU/IPA 2008	8 milion	10.2 milion	10.6																										
CEB	40 milion	51.2 milion	53.1																										
TOTAL i Siguruar	75.3 milion	96.4 milion																											
	Kontributi i CEB-it nga Llogaria Norvegjeze e Mirëbesimit	Një komponent i bazuar në grant i asistencës teknike prej 180 000 do të merret nga Llogaria Norvegjeze e Mirëbesimit të CEB-it nëpërmjet një Marrëveshjeje të veçantë Kontributi. CEB NTA mendohet të japë mbështetje teknike për komponentin monitorimit dhe vlerësimit të Projektit. Ndërkohë, është parashikuar përpilimi i një Udhëzuesi për Monitorimin dhe vlerësimin dhe trajnimin e personelit të ADF-së në sferat në lidhje me menaxhimin dhe monitorimin e projektit, nëse ka fonde.																											
	Përparimi i punëve në momentin e aplikimit të Huasë:	10%																											
	Grafiku i punëve:	2009 - 2012																											
	Data e Parashikuar për Përfundimin e Projektit	Qershor 30, 2012																											
	Data e Mbylljes	Dhjetor 31, 2012																											
	Kushte të veçanta	Para kështit të parë të huasë, PIA do t'i japë CEB-it listën paraprake të nën-projekteve dhe Planin paraprak të Prokurimit. Nën-projektet konsiderohen të përshtatshëm për procedurat e financimit të CEB-it në lidhje me aprovimin e tyre nga PIA kanë filluar deri para 12 muaj para nënshkrimit të Marrëveshjes.																											
III.	Kriteret e përshtatshmërisë: (sipas sferës së ndërhyrjes)	Programi duhet të përmbushë objektivat e CEB-it në kuptimin e grupeve të synuara sipas Rezolutës 1495 (2006).																											
IV.	Efektet sociale: (sipas zonës së ndërhyrjes)	Projekti do të përmirësojë do të lehtësojë për popullatën rurale mundësi të ndryshme jetese duke përmirësuar kushtet e rrugëve. Projekti do të ketë gjithashtu një ndikim pozitiv në forcimin e autorizimit të qytetarëve vendas nëpërmjet një qëndrimi pjesëmarrës në përzgjedhjen e rrugëve lokale të projektit dhe mirëmbajtjes së rrugëve.																											

Shtojca 2 A
LETËR SHOQËRUESE MODEL PËR NJË HUA ME NORMË FIKSE (MODEL)

F/P 1665 – [numri] transh

BANKA E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR ZHVILLIMIN
LETËR SHOQËRUESE

Në kuadrin e Marrëveshjes së Huasë e datës [data]

Ndërmjet BANKËS TË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR ZHVILLIM

(këtu quhet “CEB”)

dhe

Republikës së Shqipërisë

(këtu quhet “Huamarrësi”)

Kjo *Letër Shoqëruese* dhe Marrëveshja Kuadër e Huasë përcaktojnë termat dhe kushtet e miratuara për [numër] transhin duke iu referuar Nenit 3 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë.

Shuma e Huasë

Euro [**shuma**]

Maturimi

[numër] vit maturimi përfundimtar me një [numër] vitesh afat pa pagesë

Interesi me normë fikse

[përqindja) (neto) në vit pas zbritjes së subvencionit të interesit nga Llogaria e Përzgjedhur e Mirëbesimit

Pagesa e interesit

gjysmë vjeçare ose vjeçare për pagesat e prapambetura

Fraksioni i Numërimit të Ditëve

30/360 e parregulluar, Modifikuar sipas Konventës pas Ditës së Punës

Ditë e Punës

siç përcaktohet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë

Data e Disbursimit

[data]

Udhëzimet e Pagesës (Huamarrës)

Numri i llogarisë [numër] ose [emri i Bankës dhe qyteti]
SWIFT CODE: [shifër] nëpërmjet [emri bankës dhe qytetit përkatës]
SWIFT CODE [shifër]

Udhëzimet e Pagesave (CEB) Sipas Nenit 3.4 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë

Pagesat për interesin dhe principalin do të bëhen në pajtim me Grafikun e bashkangjitur të Shlyerjeve. Ndërsa interesi do të paguhet për herë të parë më (datë), principalin do të shlyhet për herë të parë më (datë).

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it sipas Udhëzimeve të Pagesës (CEB) të përshkruar më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes “Konventës së Modifikuar pas Ditës së Punës”,

përkufizimi i së cilës gjendet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe Huamarrësit në [datë].

[Qyteti, *datë*]

Për Bankën e Zhvillimit
të Këshillit të Evropës

[Qyteti, *datë*]

Për Republikën e Shqipërisë

Shtojca 2 B

LETËR SHOQËRUESE PËR NJË HUA ME NORMË INTERESI VARIABËL (MODEL)

F/P 1665 – [numri] Transh

BANKA E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR ZHVILLIMIN

LETËR SHOQËRUESE

Për Marrëveshjen Kuadër të Huasë e datës [data]

Ndërmjet

BANKËS SË KËSHILLIT TË EUROPEËS PËR ZHVILLIMIN

(këtu quhet “CEB”)

dhe

Republikës së Shqipërisë

(këtu quhet “Huamarrësi”)

Kjo Letër Shoqëruese dhe Marrëveshja Kuadër e Huasë përcaktojnë termat dhe kushtet e miratuara për [numër] këstin duke iu referuar nenit 3 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë.

Shuma e Huasë

Euro [*shuma*]

Maturimi

[numër] vit maturimi përfundimtar me një [numër] vitesh afat pa pagesë

EURIBOR

[fut përkufizimin e EURIBOR]

Interesi me normë variabël

EURIBOR 3 ose 6 muaj plus ose minus [numër] pikë bazë [neto] në vit pas zbritjes së subvencionit të normës së interesit nga Llogaria e Përzgjedhur e Mirëbesimit
(Telerate [*referencë*] ose Reuters [*reference*])

Pagesa e interesit

semestrale/gjysmë viti për pagesat e prapambetura

Fraksioni i Numërimit të Ditëve

aktuale/360, modifikuar sipas Konventës së Modifikuar të Ditës Pasuese së Punës

Ditë e Punës

siç përcaktohet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë

Data e Disbursimit

[data]

Udhëzimet e Pagesës (Huamarrës) Numri i llogarisë [numër] ose [emri i Bankës dhe qyteti]
SWIFT CODE: [shifër] nëpërmjet [emri bankës dhe qytetit
përkatës]
SWIFT CODE [shifër]

Udhëzimet e Pagesës (CEB) Sipas Nenit 3.4 të Marrëveshjes Kuadër të Huasë

{Tekst për normën bazë të EURIBOR-it dhe struktura e huasë amortizuese.

Norma e interesit do të llogaritet për secilin afat mujor [numër], duke filluar nga data e disbursimit.

Interesi do të caktohet dy ditë pune para secilës periudhe të re interesi. CEB-i do të informojë

Huamarrësin në lidhje me interesin e pagueshëm çdo [numër] muaj. Paga e interesit do të bëhet më
[dita, muaji]¹ çdo vit dhe për herë të parë më [datë]. ***[rendisni datat e pagesës dhe shumën principate
për secilën datë]}***

Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë e CEB-it sipas Udhëzimeve të Pagesës (CEB) të përshkruar
më sipër.

Këto dispozita i nënshtrohen marrëveshjes “Konventës së Modifikuar të Ditës Pasuese të Punës”,
përkufizimi i së cilës gjendet në Marrëveshjen Kuadër të Huasë, të nënshkruar ndërmjet CEB-it dhe
Huamarrësit në [datë].

[Qyteti, datë]

Për Bankën e Zhvillimit
të Këshillit të Evropës

[Qyteti, datë]

Për [Emri i Huamarrësit]

¹ përmend 4 data për pagesa semestrale dhe 2 data për pagesa gjysmë-mujore.

SHTOJCË 3

PARIMET E CEB-IT PËR MENAXHIMIN E AMBIENTIT

Qëllimi i parimeve për analizimin e aspekteve ambientaliste i paraqitur më poshtë është si vijon:

1. Sigurimi që projektet e financuara nga Banka të kenë kaluar kontrollin paraprak për ambientin (vlerësimi paraprak) dhe që aspektet e tyre ambientaliste të jenë marrë parasysh;
2. Mënjanimi i rreziqeve ambientaliste dhe mosmarrëveshjeve që mund të rrezikojnë zbatimin dhe funksionimin e Projektit;
3. Sigurimi që shpenzimet në lidhje me masat përkatëse për mbrojtjen e ambientit të vlerësohen dhe integrohen në shpenzimet e përgjithshme të projektit.

Huamarrësi duhet të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për vlerësimin ambientalit të projektit.

Projektet e zbatuara në një Shtet Anëtar të Bashkimit Evropian ose një Shtet Aderues ose në një vend që i përket Hapësirës Ekonomike Evropiane (EES) duhet të jetë në pajtim me rregullat ambientaliste evropiane, parimet kryesore të të cilëve janë:

- parimi i kujdesit, parimi i parandalimit, parimi sipas të cilit prioritet i jepet trajtimit të problemeve ambientaliste në burim, dhe parimi “ndotësi paguan”;
- Direktivat Evropiane në lidhje me studimet e ndikimit në ambient (EIS);
- Direktivat evropiane në lidhje me prodhimin industrial, menaxhimin e ujërave dhe mbeturinave, ndotjen e tokës dhe ajrit dhe mbrojtjen e natyrës.

Për më tepër, projektet duhet të respektojnë të gjitha konventat dhe marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare.

Për projektet e zbatuara në një shtet anëtar tjetër të CEB-it, duhet të zbatohen të njëjtat parime, në pajtim me përputhshmërinë e tyre me kushtet dhe ligjet vendase.

Dispozitat për analizimin e aspekteve ambientaliste të zbatueshme për të gjithë projektet janë si më poshtë:

A. Ndikimi Ambientalist

- Çdo projekt duhet t'i nënshtrohet një kontrolli paraprak për çdo dëmtrim të mundshëm që mund t'i shkaktojë ambientit;

- Kjo analizë duhet ta bëjë të mundur klasifikimin e projekteve sipas kriterëve përkatëse sipas përcaktimit në Direktivën 85/337/CEE në lidhje me vlerësimin e ndikimit në ambient të projekteve të caktuar publike dhe private;

Një Studim i Ndikimit në Ambient duhet të kryhet nga një organ i pavarur në rastin e projekteve zbatimi dhe/ose funksionimi i të cilëve kanë një potencial të konsiderueshëm për të dëmtuar ambientin.

B. Rreziqet për ambientin

- Çdo projekt duhet t'i nënshtrohet kontrollit paraprak për rreziqet për ambientin që mund të rrezikonte zbatimin dhe/ose funksionimin korrekt të tij;

- Disa shembuj jo-shterues të projekteve të rrezikshëm janë ata të zbatuar për:

- Tokën e lirë industriale të mëparshme (rreziqet e tokës dhe ujërave nëntokësorë të kontaminuar)

- Trojet pranë instalimeve të rrezikshme;

- Zonat sizmike (rreziqet nga tërmetet, shkarjet e tokës etj).

Për çdo projekt që mund të ekspozohet karshi rreziqeve thelbësore ambientaliste, duhet të kryhet një Diagnostikim Ambientalist (ED);

ED-ja duhet të përfshijë një analizë të masave të marra për të kaluar rreziqet ambientaliste të shkaktuara.

NËNPROJEKTI I ZGJEDHUR NGA ADF		
REF. :		Datë:
RRETHI:		
Komuniteti Lokal:		
Kryetari i Komunës ose kreu i komunitetit		
Tipi i investimit:		
Emri i nënprojektit:		
1) Ndikimi ekonomik dhe social:		
Popullata e interesuar		
Numri i familjeve të interesuara		
Qëllimet e Projektit:		
2) Përshkrimi i punës:		
3) Grafku i punës:		
4) Kostoja		
Zëri	ALL	EUR
Ndërtimi		
Pajisje		
Asistencë teknike (trajnim)		
TOTALI		
5) Ndikimi në ambient:		

Raporti i Përparimit Progresiv

ALBANIA

F/P - Rrugë dytësore dhe lokale në Shqipëri

Përmbledhje e statusit të Projekti të datës

Kostoja e Planifikuar e Projektit
EUR 75,300,000

Plan Finacimi:

Hua e CEB-it:
EUR 40,000,000

Dhurimi i CEB-it (NTA): EUR 180,000

BB/IDA - EUR 15,600,000

Fondi OPEC - EUR 11,700,000

Fondet EU/IPA 2008 - EUR 8,000,000

Fillimi i Faktik i Programit (Datë):

Data e Planifikuar e Përfundimit: 30/06/2012

% disbursuar nga burimet e financimit

Objektivat:

Te rite zhvillimin e qendrueshem social dhe ekonomik ne zonat rurale dhe te izoluara te vendit, permiresoje aksesin dhe inkurajoje zhvillimin ekonomik.

Historia e Disbursimeve [fundi i periudhes]

Aktuale

Te projektuara ne gjashte-mujorin e ardhshem

(Shiko bashkangjitur informacionin e perditësuar te disbursimit)

Përmbledhje e Statutit të Projektit:

Statusi i zbatimit në këtë datë është si më poshtë:

€ Raporti i Progresit me komponentë:

Komponenti 1: Përmirësimi i seksioneve prioritare të rrugëve dytësore/rajonale

Komponenti 2: Përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit të rrugëve lokale

Komponenti 3: Prezantimi i sektorit privat në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugëve lokale

€ Administrimi i Projektit

€ Kostoja dhe Finacimi i Projektit

€ ☐ Aktivitetet financiare të zbatimit të projektit gjatë (fundi i periudhës)

€ Aktivitetet teknike të zbatimit të projektit gjatë (fundi i periudhës)

€ Aktivitetet e prokurimit gjatë (fundi i periudhës)

€ Plani i propozuar për prokurimin gjatë aktivitetëve

€ Monitorimi dhe vlerësimi

€ Çështje specifike të Projektit/Sugjerime/Rekomandime

Shtojca 4b

KOSTOJA

NË EUR (pa TVSH)

VENDI: SHQIPËRI

F/P - Rrugë dytësore dhe lokale në Shqipëri

Date :

Përshkrimi i Projekteve të veçantë				KOSTOT						Komente
N	Rrethi	Komuna	Përshkrimi	Vlerësuar në Identifikim	Shuma e dhënë në datën	Paguar më [Datë]	Pagesa që pritet të bëhet në gjashtë muajt e ardhshëm	Pjesa që mbetet deri në përfundim	Kostoja totale	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10 = 7+8+9	11
Nën-projektet të plotë										
Ndërtim (komponenti 1: përmirësimi i seksioneve prioritare të rrugëve dytësore / rajonale										

Ndërtim (komponenti 2: Përmirësimi i seksioneve prioritare të rrjetit të rrugëve lokale)							
TA (trajnim) (komponenti 3: prezantimi i sektorit privat në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e rrugëve lokale)							
Kostoja operative ADF							
Masa të paparashikuara							
Totali i Përgjithshëm							

TABELA 1

Shtojca 4b
PLANI I PROKURIMIT
Në Euro (pa TVSH)

Vendi: Shqipëri

F/P - Rrugët dytësore dhe lokale në Shqipëri

Date:

[illegible]**TABELA 2A**

Shtojca 4b

Shpenzimet e Akumuluar nga metoda e prokurimit

Në Euro (pa TVSH)

Vendi: Shqipëri

F/P - Rrugët dytësore dhe lokale në Shqipëri

Date:

Kategoria e Shpenzimeve	Metoda e prokurimit				Kostoja Totale	Komente
	ICB	NCB	Të tjera	NBF		
1. Punimet						
2. Mallra / Pajisje						
3. Shërbime						
TOTALI						

TABELA 2B

Shkurtime:

ICB: Ofertim Ndërkombëtar Konkurrues

NCB: Ofertim Kombëtar Konkurrues

NBF: E Pa financuar nga Banka

Shtojca 4b

LISTA E KONTRATAVE TË DHËNA

Vendi: Shqipëri

F/P - Rrugët dytësore dhe lokale në Shqipëri

Date:

Data e kontratës	Përshkrimi i kontratës	Kategoria	Metoda e prokurimit *	Dhënë (emri i kontraktorit)	Kostoja		Çmimi fiks (Y=Po N=Jo)	Shuma e Paguar datë ...	Periudha e Zbatimit		Data e dhënies	Komente
					Monedha	Shuma			Fillon	Mbarimi		

TABELA 2C

* Shkurtime e përdorura :

ICB = Ofertim ndërkombëtar konkurrues; NCB = Ofertim kombëtar konkurrues; SH = Blerje; QCBS = Përzgjedhje në bazë të cilësisë dhe koston; CQ = Kualifikimet e Konsulentit; LCS = Përzgjedhja e koston më të ulët; FBS = Përzgjedhje me Buxhet Fiks

Shtojca 4b

Plani financiar Në Euro (pa TVSH)

Vendi: Shqipëri

Date :

F/P - Rrugët dytësore dhe lokale në Shqipëri

.....

Zëri	Kostoja e Vlerësuar	PAGUAR NGA QË NGA [Date]					Për TU PAGUAR NË GJASHTË MUJORIN TJETËR NGA QË NGA [Date]					Komente
		CEB	BB	Fondi OPEC	Fondi EC - IPA	TOTALI	CEB	BB	Fondi OPEC	Fondi EC - IPA	TOTALI	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Kostoja e Investimit (ndërtimi)												
Asistencë teknike												
trajnim												
Mallra												
Kostoja Operative ADF												
Masa të paparashikuara												
Totali i Përgjithshëm												

TABELA 3

Shtojca 4b
Grafiku i Operacioneve

Vendi: Shqipëri

F/P - Rrugët dytësore dhe lokale në Shqipëri

Date :

.....

Shtirirja kohore/Aktivitete	Viti 1 ^[1]												Viti 2 ^[1]								Viti 3 ^[1]								Komente	
	Semestri 1			Semestri 2			Semestri 3			Semestri 4			Semestr i 1		Semestri 2		Semestri 3		Semestr i 4		Semestri 1		Semestri 2		Semestri 3		Semestr i 4			

TABELA 4

[1] Jeni të lutur të vendosni numrin e viteve të zbatimit në fillim të programit

Planifikuar për t'u përditësuar me përparimin e aktiviteteve gjatë zbatimit

Shtojca 4b

VENDI: SHQIPËRI

Date :

F/P - Rrugë Dytësore dhe Lokale në Shqipëri

		Numri i Projekteve	Numri i Përfituesve (nr ose % e komuniteteve të përshtatshme me mundësinë e marrjes së shërbimeve dhe tregjeve	Kostoja e mirembajtjes	Të ardhurat operative	Kostoja Mesatare për Nënprojektin/ Milion LEK	Kostoja mesatare për përfituesin LEK	Të tjera
		1	2	3	4	5	6	7
PLANIFIKUAR [1]	KOMUNITETET RURALE / URBANE							
	RAJONI							
REZULTATI [2]	KOMUNITETET RURALE / URBANE							
	RAJONI							

TIPI [3]	Numri i nënprojekteve			Sasia	Sasia		
	Dytësore	Rajonal	Totali	Njësia	Rurale/Urbane	Rajonale	Totali
Rruga (seksioni rrugor)				km			
Urë				ml			
Tunele				km			
Të tjera [4]							
Totali							

TABELA 5

[1] të mbushet para financimit të projektit

[2] Të mbushet në momentin e përfundimit të projektit

[3] Të mbushet gjatë zbatimit të projektit

[4] Të mbushet nëse është e nevojshme dhe të specifikohet

LIGJ
Nr.10 122, datë 11.5.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR NJË
FINANCIM SHITESË PËR PROJEKTIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për një financim shtesë për projektin e ofrimit të shërbimeve sociale”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.6163, datë 13.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE HUAJE
(FINANCIM SHITESË PËR PROJEKTIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SOCIALE) NDËRMJET
SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Më datë _____ 2009

Marrëveshje e datës _____ 2009, mes SHQIPËRISË (“Huamarrësi”) dhe BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (“Banka”) për qëllimin e ofrimit të financimit shtesë për veprimtari lidhur me Projektin Fillestar (siç përcaktohet te Shtojca e kësaj Marrëveshjeje). Me anë të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushtet e Përgjithshme; Përkufizimet

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen te Shtojca e kësaj Marrëveshjeje) përbëjnë një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e shkruara me [shkronja] të mëdha, të cilat përdoren në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që iu vihen atyre te Kushtet e Përgjithshme ose te Shtojca e kësaj Marrëveshjeje.

1.03 Të gjithë dispozitat e Marrëveshjes Fillestare mbeten tërësisht në fuqi.

Neni 2

Huaja

2.01. Banka bie dakord t’i japë Huamarrësit, me kushtet dhe afatet që përcaktohen ose përmenden në këtë Marrëveshje, shumën prej pesë milion dollarë amerikanë (\$5.000.000), ku kjo

shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet një Konvertimi të Monedhës në përputhje me dispozitat e Seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje (“Huaja”), me qëllim që të kontribuojë në financimin e Projektit që përshkruhet te Programi 1 e kësaj Marrëveshjeje (“Projekti”).

2.02 Huamarrësi mund t’i tërheqë shumat e Huasë në përputhje me Seksionin IV të Programit 2 së kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Pagesa fillestare që bën Huamarrësi është e barabartë me një të katërtën e një përqind (0.25%) të shumës së Huasë.

2.04 Interesi që paguan Huamarrësi për çdo Periudhë Interesi ka një normë të barabartë me LIBOR-in për Monedhën e Huasë plus Marzhin Variabël; me kusht që, pas Konvertimit të të gjithë ose një pjese të shumës kryesore të Huasë, interesi që paguan Huamarrësi gjatë Periudhës së Konvertimit për këtë shumë të përcaktohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Nenit IV të Kushteve të Përgjithshme. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse një shumë e Huasë së Tërhequr mbetet papaguar kur është e kërkueshme dhe një mospagim i tillë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi që paguan Huamarrësi, nga ana tjetër, përlllogaritet siç parashikohet te Seksioni 3.02 (d) i Kushteve të Përgjithshme.

2.05 Datat e Pagesës janë 15 mars dhe 15 shtator të çdo viti.

2.06 Shuma kryesore e Huasë shlyhet sërish në përputhje me afatin e shlyerjes që parashikohet te Shtoja 3 e kësaj Marrëveshjeje.

2.07.a) Huamarrësi, në çdo kohë, mund të kërkojë një prej Konvertimeve të mëposhtme të afateve të Huasë me qëllim që të mundësojë menaxhimin e kujdesshëm të borxhit: (i) ndryshimin e Monedhës së Huasë të të gjithë apo të një pjese të shumës kryesore të Huasë, të tërhequr apo të patërhequr, në një Monedhë të Miratuar; (ii) ndryshimin e bazës së normës së interesit që zbatohet për të gjithë ose një pjesë të shumës kryesore të Huasë, së tërhequr dhe të pashlyer, nga një Normë e Ndryshueshme në një Normë Fikse, ose anasjelltas; dhe (iii) caktimin e kufijve për Normën e Ndryshueshme që zbatohet për të gjithë ose një pjesë të shumës kryesore të Huasë, së tërhequr dhe të pashlyer, nga vendosja e Tavanit të Normës së Interesit apo Kufirit të Normës së Interesit për Normën Variabël.

b) Çdo konvertim që kërkohet në mbështetje të paragrafit (a) të këtij Seksioni, i cili është pranuar nga Banka, konsiderohet “Konvertim”, siç përcaktohet te Kushtet e Përgjithshme, dhe kryhet në përputhje me dispozitat e Nenit IV të Kushteve të Përgjithshme dhe të Udhëzuesve për Konvertimin.

c) Menjëherë pas Datës së Hyrjes në Fuqi të Tavanit të Normës së Interesit ose të Kufirit të Normës së Interesit për të cilin Huamarrësi ka kërkuar që kësti të paguhet nga Shumat e Huasë, Banka, në emër të Huamarrësit, tërheq nga Llogaria e Huasë dhe i paguan vetes shumat e nevojshme për të paguar çdo këst që duhet paguar, në përputhje me Seksionin 4.05 (c) të Kushteve të Përgjithshme, deri në shumën që alokohet herë pas here për qëllimin e dhënë në tabelën në Seksionin IV të Programit 2 së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3 Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin ndaj objektivave të Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi e realizon Projektin nëpërmjet PIU-t (Njësia e Zbatimit të Projektit), në përputhje me dispozitat e Manualit të Veprimeve, Planin për Menaxhimin e Mjedisit, Planin për Prokurimet dhe Nenin V të Kushteve të Përgjithshme.

3.02 Pa u kufizuar te dispozitat e Seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, dhe përveç kur Huamarrësi dhe Banka bien përndryshe dakord, Huamarrësi bën kujdes që Projekti të zbatohet në përputhje me dispozitat e Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

NENI IV HYRJA NË FUQI; PËRFUNDIMI I KONTRATËS

4.01. Kushtet Shtesë të Hyrjes në Fuqi përbëhen nga sa më poshtë:

a) PIU punëson një menaxher Projekti me terma reference dhe kualifikime të kënaqshme për Bankën; dhe,

b) Huamarrësi përditëson Manualin e Veprimeve në formë dhe me përmbajtje të pëlqyeshme

për Bankën.

4.02. Afati i Hyrjes në Fuqi është (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Përfaqësuesi; adresat

5.01.Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministria e Financës.

5.02. Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financës
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Faks: 355 42 28494

5.03.Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Kabllogram:

Teleks:

Faks:

INTBAFRAD
Washington, D.C.

248423(MCI) or
64145(MCI)

1-202-477-6391

LIDHUR më _____, _____, në ditën dhe vitin që shkruhet më sipër.

SHQIPËRIA

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

BANKA NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

Përfaqësuesi i autorizuar

PROGRAMI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e Projektit janë që të përmirësohen standardet e jetesës së grupeve të varfra dhe të cenueshme të popullsisë në Shqipëri: (i) duke rritur mundësinë që ata të përdorin shërbime të efektshme të kujdesit social, dhe (ii) duke ndihmuar Qeverinë që të hartojë një politikë efektive të kujdesit social dhe të përmirësojë kapacitetet e saj për shpërndarjen dhe monitorimin e shërbimeve të kujdesit social; si dhe të përmirësojë efektivitetin dhe efektshmërinë e sistemit të pensioneve në Shqipëri nëpërmjet (i) përmirësimit të administrimit të sistemit të pensioneve; (ii) fuqizimit institucional, përfshirë përmirësimin e kapaciteteve për hartimin e politikave për pensionet; dhe (iii) përmirësimit të perceptimit të publikut për sistemin e pensioneve.

Projekti përbëhet nga Projekti Fillestar dhe pjesa e mëposhtme shtesë:

Pjesa E: Reforma në Sistemin e Pensioneve

1. Reforma administrative në sistemin e pensioneve nëpërmjet ofrimit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe zbatimit të punëve civile, përfshirë:

a) shqyrtimin e planit strategjik të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe hartimit të një plani pune;

b) shqyrtimin e proceseve ekzistuese të punës të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe hartimi i të tjera proceseve të tilla;

c) projektimin dhe zhvillimin e programeve kompjuterike për të mbështetur proceset e reja të punës të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfshirë trajnimin e personelit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për këtë;

d) krijimin dhe zbatimin e një sistemi të përgjithshëm të menaxhimit financiar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, përfshirë: (i) një sistem transparent kontabiliteti në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit; (ii) përmirësimin e proceseve të buxhetimit; dhe (iii) krijimin e një programi të përgjithshëm për kontrollin e brendshëm;

e) trajnimin e stafit drejtues të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për praktikën e reja të menaxhimit, planifikimit, komunikimit dhe analizën e proceseve;

f) projektimin dhe zbatimin e sistemeve për mbrojtjen e të dhënave dhe të sigurisë për Institutin e Sigurimeve Shoqërore; dhe,

g) kryerjen e punëve civile për restaurimin dhe rehabilitim fizik të zyrave të përzgjedhura qendrore dhe rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Krijimi i Regjistrit Qendror të Kontribuuesve dhe Përfituesve nëpërmjet ofrimit të mallrave dhe shërbimeve, përfshirë:

a) dixhitalizimin e dokumentacionit për punët në të kaluarën;

b) krijimin e një sistemi arkivor të kontributeve dhe përfitimeve për të mundësuar dhënien e përfitimeve;

c) krijimin e një sistemi të ri raportimi lidhur me kontributet për pensionet;

d) krijimin e një sistemi të integruar të programeve kompjuterike për menaxhimin e këtij Regjistri;

e) krijimin e një rrjeti të teknologjisë së informacionit mes zyrave rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, selisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe institucioneve të tjera kryesore; si dhe,

f) mobilitet për zyrat e këtij Regjistri.

3. Krijimi i kapaciteteve për hartimin e politikave për pensionet nëpërmjet ofrimit të mallrave dhe shërbimeve për ngritjen e një njësie të ngarkuar me përcaktimin dhe analizën e politikave për pensionet brenda Institutit të Sigurimeve Shoqërore, përfshirë:

a) kryerjen e analizës së zgjedhjeve, përsa i përket reformës në sistemin parametrik dhe të tërësishëm të pensioneve; dhe,

b) krijimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për zgjedhjet, përsa i përket reformës në sistemin e përzgjedhur të pensioneve.

4. Edukimi i publikut me sistemin e pensioneve nëpërmjet ofrimit të mallrave dhe shërbimeve, përfshirë:

a) përgatitjen dhe kryerjen e një sondazhi të opinionit publik;

b) krijimin e një strategjie për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm;

c) kryerjen e një fushate për edukimin e publikut; dhe,

d) organizimin e veprimtarive dhe seminare të ndryshme për edukimin e publikut.

5. Menaxhimi i Projektit dhe mbështetja për zbatimin nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për Kostot Operative Rritëse të PIU-it dhe financimin e tyre.

PROGRAMI 2

Zbatimi i Projektit

Seksioni I. Procedurat e zbatimit

A. Procedurat institucionale. Huamarrësi e zbaton Projektin nëpërmjet PIU-t, i cili kryesohet nga një menaxher Projekti, nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Zëvendës drejtorit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Menaxheri i Projektit mban përgjegjësi për menaxhimin dhe zbatimin e përgjithshëm të Projektit dhe, së bashku me PIU-n, është i ngarkuar për prokurimin, menaxhimin financiar, planifikimin, bashkërendimin, monitorimin, raportimin, vlerësimin dhe aspektet mjedisore dhe sociale të Projektit. Huamarrësi, gjatë kohëzgjatjes së Projektit, i siguron PIU-t burime të mjaftueshme dhe personel të kualifikuar në numër të mjaftueshëm, përfshirë një menaxher Projekti dhe specialistë për prokurimin dhe menaxhimin financiar mbi bazën e kualifikimeve dhe termave të referencës të kënaqshme për Bankën.

B. Anti-korrupsioni

Huamarrësi bën kujdes që Projekti të realizohet në përputhje me dispozitat e Udhëzuesve për Anti-Korrupsionin.

C. Kushtet e zbatimit

1. Huamarrësi e realizon Projektin në përputhje me dispozitat e Manualit të Veprimeve, Planin për Menaxhimin e Mjedisit dhe Planin për Prokurimet. Huamarrësi nuk ndryshon, pezullon, shfuqizon, anulon apo heq dorë nga ndonjë dispozitë e këtij Manuali, nga Plani për Menaxhimin e Mjedisit apo Plani pa miratimin paraprak të Bankës.

2. Për qëllimet e Pjesës E.1 (g) të Projektit, Huamarrësi bën kujdes që punët civile: (a) kryhen vetëm për zyrat ekzistuese qendrore dhe rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, tokën që është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Huamarrësit dhe pronësia publike e të cilës është vërtetuar; dhe (b) nuk sjell si pasojë blerjen e tokës apo ndonjë risistemim të pavullnetshëm, siç përcaktohet në Politikën Operative të Bankës Botërore 4.12. Nuk kryhet asnjë punë civile nëse Huamarrësi paraprakisht: (a) nuk ka bërë kujdes që lista e gjërave që duhen bërë e Planit për Menaxhimin e Mjedisit, të zbatohet për çdo dokument të detyrueshëm dhe të përbëjë një pjesë të pandarë të çdo kontrate lidhur me këto punë; dhe (b) nuk ka kërkuar miratimin paraprak të Bankës për çdo shesh që është propozuar për këto punë.

3. Huamarrësi, jo më vonë sesa data 31 janar i çdo viti, siguron alokimet në buxhetin vjetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të mjaftueshme për çdo vit të zbatimit të Projektit.

4. Huamarrësi, jo më vonë sesa data 1 mars 2010, krijon dhe, pas kësaj, mban gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit, një drejtor statistikash të sigurimeve shoqërore brenda Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me burime të mjaftueshme, staf të kualifikuar në numër të mjaftueshëm dhe mbi bazën e termave të referencës të pëlqyeshëm për Bankën.

5. Huamarrësi bën që Instituti i Sigurimeve Shoqërore, jo më vonë se data 30 shtator 2009, të lidhë një marrëveshje me Drejtorinë e Tatimeve, përfshirë një kalendar dhe protokoll, të pranueshëm për Bankën, për ofrimin e të dhënave për kontributet në format elektronik nga Drejtoria e Tatimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

6. Huamarrësi, nëpërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, jo më vonë se data 1 qershor 2010, krijon dhe, pas kësaj, mban një sistem të brendshëm të menaxhimit financiar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, përfshirë një sistem të kompjuterizuar të kontabilitetit dhe raportimit, të pranueshëm për Bankën.

Seksioni II. Raportimi për monitorimin e Projektit dhe vlerësimi i tij

A. Raportet për Projektin

1. Huamarrësi, nëpërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, monitoron dhe vlerëson ecurinë e Projektit dhe përgatit Raporte për Projektin në përputhje me dispozitat e Seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve për të cilat është rënë dakord me Bankën. Çdo Raport për Projektin përfshin periudhën e një tremujori kalendarik dhe i dorëzohet Bankës jo më vonë sesa dyzetepesë (45) ditë pas përfundimit të periudhës që përfshin ky raport.

2. Për qëllime të Seksionit 5.08 (c) të Kushteve të Përgjithshme, raporti për ekzekutimin e Projektit dhe plani përkatës që kërkohet në mbështetje të këtij Seksioni i dorëzohen Bankës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas Datës së Mbylljes.

B. Menaxhimi financiar, Raportet financiare dhe auditimet

1. Huamarrësi, nëpërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, mban ose bën që të mbahet një sistem menaxhimi financiar në përputhje me dispozitat e Seksionit 5.09 të Kushteve të Përgjithshme.

2. Pa u kufizuar te dispozitat e Pjesës A të këtij Seksioni, Huamarrësi përgatit dhe i dorëzon Bankës, jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, raporte të përkohshme financiare të paaudituar për Projektin që përfshijnë tremujorin, në formë dhe me përmbajtje të pëlqyeshme për Bankën.

3. Pasqyrat Financiare të Huamarrësit auditohen në përputhje me dispozitat e Seksionit 5.09 (b) të Kushteve të Përgjithshme. Çdo auditim i Pasqyrave Financiare përfshin periudhën e një viti financiar të Huamarrësit. Pasqyrat e audituara Financiare për këtë periudhë i dorëzohen Bankës jo më vonë sesa gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallra dhe punime. Të gjitha mallrat dhe punimet, që janë të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen me shumat e Huasë, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen ose përmenden në Seksionin I të Udhëzuesve për Prokurimet, si dhe me dispozitat e këtij Seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjithë shërbimet e konsulentëve, që janë të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga shumat e Huasë, prokurohen në përputhje me kërkesat që përcaktohen ose përmenden në Seksionet I dhe IV të Udhëzuesve për Konsulentët, si dhe me dispozitat e këtij Seksioni.

3. Përkufizimet. Termat e shkruara me [shkronja] të mëdha, të cilat përdoren më poshtë në këtë Seksion për të bërë përshkrimin e metodave të posaçme të prokurimit ose të metodave të shqyrtimit të kontratave të posaçme nga ana e Bankës, i referohen metodës përkatëse që përshkruhet te Udhëzuesit për Prokurimet apo te Udhëzuesit për Konsulentët, sipas rastit.

B. Metoda të Posaçme për Prokurimin e Mallrave dhe Punimeve

1. Tender për Konkurrin Ndërkombëtar. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe punimet prokurohen sipas kontratave që jepen mbi bazën e procedurave të Tenderit për Konkurrin Ndërkombëtar.

2. Metoda të Tjera për Prokurimin e Mallrave dhe Punimeve. Tabela e mëposhtme specifikon metodat për prokurim, përveç Tenderit për Konkurrin Ndërkombëtar, të cilat mund të përdoren për mallra dhe punime. Plani për Prokurimet përcakton saktë rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda.

Metoda e prokurimit
a) Tender me Konkurrin Kombëtar, sipas ndryshimeve dhe shtesave që parashikohen në paragrafin 3 më poshtë.
b) Blerja
c) Kontraktimi i drejtpërdrejtë

3. Ndryshimet e Procedurave të Tenderit të Huamarrësit me Konkurrin Kombëtar. Procedurat e Tenderit me Konkurrin Kombëtar mbështeten te procedurat e Tenderit të Hapur, siç përcaktohet në Ligjin Shqiptar për Prokurimet Publike (Ligji nr. 9643, datë 20 nëntor 2006, i ndryshuar) dhe në dispozitat e mëposhtme shtesë:

i) Procedurat e "Tenderit të Hapur", siç përcaktohen në Ligjin Shqiptar për Prokurimet Publike, zbatohen për të gjitha kontratat;

ii) ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga tenderimi dhe gjatë procesit të tenderimit për ofertuesit kombëtarë nuk tregohet asnjë lloj preference. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri lejohen të bëjnë ofertë vetëm nëse ato janë autonome nga pikëpamja ligjore dhe financiare dhe veprojnë në bazë të ligjit të Huamarrësit për shoqëritë tregtare;

iii) subjektet prokuruese përdorin dokumente tenderimi model të miratuara nga Banka;

iv) në rast të çmimeve më të larta të ofertave, krahasuar me vlerësimin zyrtar, nuk refuzohet asnjë ofertë pa miratimin paraprak të Bankës;

v) për dorëzimin e ofertave përdoret procedura me një zarf të vetëm;

vi) paskualifikimi parashikohet vetëm për ofertuesin që jep vlerat më të ulëta; asnjë ofertë nuk refuzohet në kohën e hapjes së ofertave për qëllime kualifikimi;

vii) ofertuesit, që kontraktajnë si sipërmarrje e përbashkët, konsiderohen përgjegjës në mënyrë solidare dhe individuale;

viii) kontratat i jepen ofertuesit me përgjegjësi kryesore që jep vlerat më të ulëta, i cili vendoset se kualifikohet që të veprojë në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe para-deklaruara të vlerësimit;

ix) nuk lejohen negociata pas tenderimit me ofertuesit që japin vlerat më të ulëta apo ofertues të tjerë; dhe

x) kontratat me kohë të gjatë (mbi 18 muaj) përmbajnë dispozita të përshtatshme për rregullimin e çmimeve.

C. Metoda të Posaçme për Prokurimin e Shërbimeve të Konsulentëve

1. Përzgjedhja në Bazë të Cilësisë dhe Kostos. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve prokurohen në bazë të kontratave që jepen në bazë të Përzgjedhjes në bazë të Cilësisë dhe Kostos.

2. Metoda të Tjera për Prokurimin e Shërbimeve të Konsulentëve. Tabela e mëposhtme specifikon metodat për prokurim, përveç Përzgjedhjes në bazë të Cilësisë dhe Kostos, që mund të përdoren për shërbime të konsulentëve. Plani për Prokurimet përcakton qartë rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda.

Metoda për prokurim
a) Përzgjedhja në bazë të kostos më të ulët
b) Përzgjedhja në bazë të kualifikimeve të konsulentëve
c) Metoda e buxhetit fiks
ç) Përzgjedhja e konsulentëve individualë
d) Përzgjedhja e burimit të vetëm

D. Shqyrtimi nga ana e Bankës i Vendimeve për Prokurim

Plani për Prokurimet parashikon ato kontrata që i nënshtrohen Shqyrtimit Paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen Shqyrtimit të Mëvonshëm nga ana e Bankës.

Seksioni IV. Tërheqja e Shumave të Huasë

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund t'i tërheqë shumat e Huasë në përputhje me dispozitat e Nenit II të Kushteve të Përgjithshme, të këtij Seksioni dhe të udhëzimeve të tilla shtesë siç i specifikon Banka me anë të një njoftimi për Huamarrësin (përfshirë "Udhëzuesit për disbursimet nga Banka Botërore për projekte", maj 2006, që shqyrtohen herë pas here nga Banka dhe janë të zbatueshme për këtë Marrëveshjeje në mbështetje të këtyre udhëzimeve), me qëllim që të financohen Shpenzimet e Pranueshme siç parashikohet në Tabelën në paragrafin 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen me shumat e Huasë ("Kategoria"), alokimin e shumave të Huasë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që duhen financuar për Shpenzimet e Pranueshme në çdo Kategori.

Kategoria	Shuma e Huasë së Akorduar (shprehur në USD)	Përqindja e Shpenzimeve për tu financuar
1) Mallra dhe punime sipas Pjesës E të Projektit	4.557.500	80%
2) Shërbime të konsulentëve dhe trajnim sipas Pjesës E të Projektit	400.000	100%

3) Kosto Operative Rritëse sipas Pjesës E.5 të Projektit	30.000	100%
4) Prime për Tavanet e Normës së Interesit dhe Tavanet e Kufij të Normës së Interesit	0	Shumë që paguhet në mbështetje të Seksionit 2.07 (c) të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Seksionin 4.05 (c) të Kushteve të Përgjithshme
5) Tarifa fillestare	12.500	Shumë që paguhet në mbështetje të Seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me Seksionin 2.07 (b) të Kushteve të Përgjithshme
SHUMA E PËRGJITHSHME	5.000.000	

Për qëllime të Seksionit IV, “Trajnim” është çdo trajnim i personelit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që kryhet për qëllimin e arritjes së objektivave të Projektit dhe përfshirjes së shpenzimeve të mëposhtme, që në çdo rast lidhen vetëm me trajnimin dhe janë në përputhje me planin vjetor për trajnimin dhe vizitat studimore për të cilin Huamarrësi dhe Banka duhet të bien dakord: blerja, shtypja dhe botimi i materialeve; kancelaritë; tarifat e seminareve; qiraja e objekteve, siç janë pajisjet e përkthimit, godinat në të cilat duhet të bëhet trajnimi; tarifat e kursit; lajmërimet për qëllime përkthimi; transporti dhe udhëtimi; dietat e personelit që merr pjesë në trajnim (përfshirë shpenzimet për dietat).

B. Kushtet për Tërheqjen; Periudha e Tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e Pjesës A të këtij Seksioni, për pagesat e bëra përpara datës së kësaj Marrëveshjeje nuk bëhet asnjë tërheqje.

2. Data e Mbylljes është 30 shtator 2012.

PROGRAMI 3

1. Tabela e mëposhtme përcakton Datat e Pagesave Kryesore të Huasë dhe përqindjen e shumës së përgjithshme kryesore të Huasë, që duhet paguar në çdo Datë të Pagesave Kryesore (“Kësti”). Nëse shumat e Huasë tërhiqen plotësisht duke filluar nga Data e parë e Pagesave Kryesore, shumat kryesore të Huasë që shlyhet nga Huamarrësi çdo Datë të Pagesave Kryesore përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: (a) Huanë e Tërhequr duke filluar nga Data e parë e Pagesave Kryesore; me (b) Këstin në çdo Datë të Pagesave Kryesore, shumë e kthyeshme kjo që duhet përshtatur, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë që përmendet në paragrafin 4 të kësaj Shtojce, për të cilën zbatohet një Konvertim Monedhe.

Data e Pagesave Kryesore	Kësti (Shprehur si përqindje)
Çdo 15 mars dhe 15 shtator Duke filluar nga 15 shtator 2019 Deri më 15 shtator 2033	3.33%
Më 15 mars 2034	3.43%

2. Nëse shumat e Huasë nuk tërhiqen plotësisht deri në Datën e parë të Pagesave Kryesore, shumat kryesore të Huasë që shlyhet nga Huamarrësi në çdo Datë të Pagesave Kryesore, përcaktohet si më poshtë:

a) Nëse duke filluar nga Data e parë e Pagesave Kryesore tërhiqen disa shumat të Huasë, Huamarrësi e paguan Huanë e Tërhequr duke filluar nga kjo datë, në përputhje me paragrafin 1 të kësaj Shtojce.

b) Çdo shumë e tërhequr pas Datës së parë të Pagesave Kryesore shlyhet në çdo datë të Pagesave Kryesore që bie pas datës së kësaj tërheqjeje në shumat, të cilat përcaktohen nga Banka duke e vënë shumën e çdo tërheqjeje të tillë në theks, numërori i të cilës është Kësti fillestar që përcaktohet

qartë në Tabelën në paragrafin 1 të këtij Programi për këtë Datë të Pagesave Kryesore (“Kësti fillestar”) dhe emëruesi i të cilës është shuma e të gjitha Kësive Fillestare që mbeten për Datat e Pagesave Kryesore që bien në këtë datë ose pas saj, ku këto shuma të kthyeshme duhen përshtatur, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë që përmendet në paragrafin 4 të kësaj Shtojce, për të cilën zbatohet një Konvertim Monedhe.

3.a) Shumat e Huasë të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë përpara çdo Date të Pagesave Kryesore, vetëm për qëllimet e përlogaritjes së shumave kryesore të kthyeshme në çdo Datë të Pagesave Kryesore, trajtohen si të tërhequra dhe të pashlyera Datën e dytë të Pagesave Kryesore pas datës së tërheqjes dhe kthehen në çdo Datë të Pagesave Kryesore që fillon me Datën e dytë të Pagesave Kryesore pas datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit (a) të këtij paragrafi, nëse në çdo kohë Banka miraton një sistem faturimi sipas datës kur duhet bërë pagesa në bazë të të cilit faturat lëshohen në Datën përkatëse të Pagesave Kryesore ose pas saj, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk zbatohen më për tërheqjet që bëhet pas miratimit të një sistemi të tillë faturimi.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të kësaj Shtojce, me një Konvertim të Monedhës të të gjithë ose një pjese të Huasë së Tërhequr në një Monedhë të Miratuar, shuma e konvertuar në Monedhën e Miratuar që është e kthyeshme në çdo Datë të Pagesave Kryesore që bie gjatë Periudhës së Konvertimit, përcaktohet nga Banka duke e shumëzuar një shumë të tillë në monedhën e saj të vlerës pikërisht përpara Konvertimit ose me: (i) normën e këmbimit që pasqyron shumën e principalit në Monedhën e Miratuar që paguan Banka në bazë të Transaksionit Mbrojtës për Monedhën lidhur me Konvertimin; ose (ii) nëse Banka merr vendim në përputhje me Udhëzuesit për Konvertimin, me komponentin e normës së këmbimit të Normës së Kontrollit.

5. Nëse Huaja e Tërhequr emërtohet në më shumë sesa një Monedhë Huaje, dispozitat e kësaj Shtojce zbatohen veçmas për shumën e emërtuar në secilën Monedhë Huaje, me qëllim që të nxjerrë një grafik amortizimi të veçantë për çdo shumë të tillë.

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizimet

1. “Udhëzuesit për Anti-korrupsionin” janë “Udhëzuesit për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projekte të financuara me Hua të IBRD-së (BNRZH) dhe Hua dhe Grande të IDA-s (Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim)”, 15 tetor 2006.

2. “Kategoria” është një kategori që përcaktohet në tabelën në Seksionin IV të Shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. “Regjistri Qendror i Kontribuuesve dhe Përfituesve” është regjistri qendror i kontribuuesve dhe përfituesve të pensione, që është krijuar dhe funksionon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (siç përcaktohet ky term më pas).

4. “Udhëzuesit për Konsulentët” janë “Udhëzues: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrës të Bankës Botërore”, botuar nga Banka në maj 2004 dhe është rishikuar në tetor 2006.

5. “EMP” është Plani për Menaxhimin e Mjedisit, datë 8 mars 2008, përgatitur nga Huamarrësi dhe i pranueshëm për Bankën, që përfshin një listë të gjërave që duhen bërë të Planit për Menaxhimin e Mjedisit dhe parashikon masat për zbatimin e mjedisit të nevojshme për punime të vogla civile që duhen realizuar sipas Pjesës E.1(g) të Projektit.

6. “Kushtet e Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Hua”, 1 korrik 2005 (ndryshuar deri më 12 shkurt 2008), me ndryshimet e përcaktuara në Seksionin II të kësaj Shtojce.

7. “Kostot Operative Rritëse” janë shpenzime rritëse që bën PIU (siç përcaktohet ky term më pas) për llogari të menaxhimit dhe zbatimit të Projektit, përfshirë shpenzimet për përkthim, komunikim, shtypje dhe materiale, shpenzimet për udhëtim brenda vendit dhe shërbimet publike, por duke përfshirë rrogat e punonjësve civilë.

8. “Manual i Veprimeve” është manuali i datës 21 nëntor 2002, miratuar nga Huamarrësi për Projektin Fillestar (siç përcaktohet ky term më pas) dhe që duhet përditësuar nga Huamarrësi në përputhje me Seksionin 4.01 (b) të kësaj Marrëveshjeje, që përcakton rregullat dhe procedurat e zbatimit për Projektin Fillestar (siç përcaktohet ky term më pas) dhe Projektin.

9. “Marrëveshja Fillestare” është marrëveshja për Hua për zhvillim lidhur me Projektin për Shpërndarjen e Shërbimeve Sociale ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, 3 korrik 2001, e ndryshuar (numri i Huasë 3513 - ALB).

10. “Projekti Fillestar” është Projekti që përshkruhet në Marrëveshjen Fillestare.

11. “PIU” është Njësia për Zbatimin e Projektit, që është krijuar nga Huamarrësi në bazë të Marrëveshjes Fillestare dhe që mbahet në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (siç përcaktohet ky term më pas).

12. “Udhëzuesit për Prokurimet” janë “Udhëzuesit: Prokurimi në bazë të Huave të BNRZH-së dhe Huave të SHNZH-së”, botuar nga Banka në maj 2004 dhe rishikuar në tetor 2006.

13. “Plani për Prokurimet” është plani i Huamarrësit për prokurimet për Projektin, datë 10 shkurt 2009, që përmendet në paragrafin 1.16 të Udhëzuesve për Prokurimet dhe paragrafin 1.24 të Udhëzuesve për Konsulentët, meqenëse e njëjta përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e këtyre paragrafëve.

14. “SII” është Instituti i Sigurimeve Shoqërore, fond i veçantë i Huamarrësit, nën mbikëqyrjen e Ministrit të tij të Financave, përgjegjës për administrimin e sistemit të Huamarrësit të sigurimeve shoqërore, krijuar me Vendim nr. 249 të Këshillit të Ministrave, datë 5 qershor 1992.

15. “Drejtoria e Tatimeve” është drejtoria e tatimeve në Ministrinë e Financave të Huamarrësit, dhe është përgjegjëse për administrimin e procedurave të taksave, që janë krijuar dhe funksionojnë në mbështetje të Vendimit nr.8560 të Këshillit të Ministrave, datë 22 dhjetor 1999.

Seksioni II. Ndryshimet e Kushteve të Përgjithshme

Sa më poshtë janë ndryshimet e Kushteve të Përgjithshme:

1. Paragrafi (a) i Seksionit 2.07 ka ndryshuar dhe lexon si më poshtë:

“Seksioni 2.07. Rifinancimi i Paradhënies për Përgatitje; Shndërrimi në kapital i tarifës fillestare dhe interesit

a) Nëse Marrëveshja për Huanë parashikon shlyerjen me shumat e Huasë të një paradhënieje që jepet nga Banka ose Shoqata (“Paradhënie për Përgatitje”), Banka, në emër të kësaj Pale të Huasë, tërheq nga Llogaria e Huasë në Ditën e Hyrjes në Fuqi ose pas saj shumën e nevojshme për të kthyer Huanë e tërhequr dhe të pashlyer të paradhënies, duke filluar nga data e kësaj tërheqjeje nga Llogaria e Huasë dhe për të paguar të gjitha shpenzimet e grumbulluara dhe të papaguara, nëse ka, për paradhënien duke filluar nga kjo datë. Banka ia paguan shumën e tërhequr vetes ose Shoqatës, sipas rastit, dhe anulon shumën e paradhënies që ka mbetur e patërhequr.”

2. Paragrafi (l) i Seksionit 7.02 ka ndryshuar dhe lexon si më poshtë:

“Seksioni 7.02. Pezullimi nga Banka

... l) Papërshtatshmëria. Banka ose Shoqata e ka deklaruar Huamarrësin (përveç Vendit Anëtar) ose Subjektin Zbatues të Projektit të papërshtatshëm për të marrë shumat e një financimi që ka bërë Banka ose Shoqata ose, përndryshe, të marrë pjesë në përgatitjen ose zbatimin e një Projekti të financuar tërësisht ose pjesërisht nga Banka ose Shoqata, si rezultat i një vendimi të Bankës ose Shoqatës se Huamarrësi ose Subjekti Zbatues i Projektit është angazhuar në praktika mashtruese, korruptimi, detyruese ose bashkëpunimi të fshehtë në lidhje me të ardhurat e ndonjë financimi të bërë nga Banka ose Shoqata.”

3. Termat dhe përkufizimet e mëposhtme të përcaktuara në Shtojcë janë ndryshuar ose hequr si më poshtë, dhe termat dhe përkufizimet e reja të mëposhtme janë shtuar në rend alfabetik në Shtojcë si më poshtë, ku termat rinumërohen me radhë:

a) Termi “Paradhënie për Përgatitjen e Projektit” është ndryshuar dhe lexon “Paradhënie për Përgatitje” dhe përkufizimi i tij është ndryshuar dhe lexon si më poshtë:

““Paradhënie për Përgatitje” është paradhënia që përmendet në Marrëveshjen e Financimit dhe shlyhet në përputhje me Seksionin 2.07.”

b) Përkufizimi i termit “Data e Konvertimit” ka ndryshuar dhe lexon si më poshtë:

“Data e Konvertimit” është, për sa i përket Konvertimit, Data e Ekzekutimit (siç përcaktohet më poshtë) ose një tjetër datë e tillë, siç kërkohet nga Huamarrësi dhe pranohet nga Banka, në të cilën Konvertimi hyn në fuqi, dhe siç specifikohet më tej në Udhëzuesit për Konvertimin.”

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë

Hyri në shtyp më 14.5.2009
Doli nga shtypi më 14.5.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja ADELPRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë